

1 E enjte, 23 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.31

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se vini.

7 Znj. Sekretare.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është  
9 çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër  
10 Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit, znj. Sekretare.

13 Shoh që nuk jemi të gjithë ekipet në të njëjtën përbërje.

14 Ja jap fjalën me radhë palëve, Prokurorisë së pari.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Prokuroria përfaqësohet nga

16 Line Pedersen, Filippo De Minicis, Gaia Pergolo.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Mbrojtësi i Viktimave.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Simon Laws.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Avokati Mbrojtës.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Mirëmëngjesi, znj. Gjyqtare. Unë

23 jam z. Gilissen. Jemi këtu me z. Shala, z. Aouini, znj.

24 Melissa McKay, Dzeneta Petrovica. Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Shala, a mund ta konfirmoni që më dëgjoni mirë? Mirëmëngjesi.

2 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj  
3 mirë shumë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Faleminderit.

6 Sot do të vazhdojmë me pyetjet e Dëshmitares të Mbrojtjes  
7 Safete Hadërgjonaj.

8 Përpara që të bëjmë këtë gjë, Avokatët Mbrojtës, a presim  
9 ndonjë ndërhyrje nga klienti juaj sot?

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk besoj që do të ketë nevojë të  
11 flasë. Megjithatë ju mund ta pyesni për dijeni, për të qenë e  
12 sigurtë, për informacionin që kam unë, nuk do të ndërhyjë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
14 lëmë kështu atëherë, s'ka nevojë që ta pyes.

15 Në qoftë se s'ka parashtrime të tjera -- po. Prokuroria.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, Gjykatës. Sepse  
17 kam dërguar një email në mëngjes sot dhe me numrin ERN të  
18 gabuar, mendova që ishte kështu. Po, në fakt, menaxherja e  
19 rastit më tha që numri është i saktë dhe s'ka problem me këtë  
20 numër.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
22 kisha në plan ta përmendja dhe këtë, po meqenëse e keni  
23 tërhequr, në rregull.

24 Ndonjë parashtrim tjetër nga palët? Jo.

25 Atëhere, znj. Punonjëse e Gjykatës na sillni dëshmitaren

1 në sallë ju lutem.

2 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A më  
4 dëgjoni mirë? Mirë se vini, znj. Dëshmitare.

5 DËSHMITARJA: W04441

6 DËSHMITARJA: Mirë se ju gjeta. Mirëmëngjes.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Mirëmëngjes.

9 Z. Shala, a e dëgjoni dëshmitaren?

10 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë  
11 mirë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
13 rregull. Faleminderit.

14 Znj. Dëshmitare, si ndiheni sot?

15 DËSHMITARJA: Ashtu.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
17 vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju kujtoj që jeni akoma nën  
18 betim për të thënë të vërtetën. E kuptoni këtë?

19 DËSHMITARJA: Gjithsesi. E kuptoj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
21 rregull.

22 Dy komente, vërejtje që dëshiroj të bëjë, znj.

23 Dëshmitare. Dje në mënyrë të përsëritur ju ngritën çështjen që  
24 nuk e kuptonit sepse ishit thirrur të jepnit dëshmi përpara  
25 këtij Trupi Gjykses. Por që të jemi të qartë, po jua përsëris

1 sot, siç jua kam thënë edhe dje, se kjo ka qenë kërkesë e  
2 Mbrojtjes së z. Shala, i akuzuari në këtë lëndë, që ju të  
3 thirreni dhe të dëshmoni në këtë çështje. Kur Mbrojtja nuk  
4 arriti t'ju sigurojë ju si dëshmitar vetë, ata i kërkuan  
5 Trupit Gjykues.

6 Pra, Mbrojtja vlerësoi se ju ishit dëshmitare e  
7 rëndësishme në paraqitjen e provave të tyre në mbrojtje të z.  
8 Shala. Trupi Gjykues e miratoi kërkesën e Mbrojtjes sepse ka  
9 gjasa që ju keni informacione qoftë për një krim apo kryerësit  
10 e pretenduar apo rrethana të rëndësishme që janë relevante për  
11 këtë procedurë penale në rastin kundër Pjetër Shalën.  
12 Gjithsesi këtë mundësi e vlerëson Gjykatësi dhe jo ju.

13 Në cilësinë e dëshmitarit keni detyrimin që të vini të  
14 paraqiteni dhe të përgjigjeni. Uroj që kjo të jetë e qartë për  
15 ju.

16 DËSHMITARJA: Znj. Gjyqtare, faleminderit për sqarimet që  
17 m'i dhe. Sepse unë nuk kam pasë ndonjë kontakt me Avokatin  
18 ndonjë takim ose ndonjë -- dhe për mu ka qenë pak e befasishme  
19 si e kam marrë ftesën. Faleminderit që e qartësuat. Është e  
20 kuptueshme për mu. Unë iu kam përgjigj ftesës me korrektësi  
21 dhe me korrektësi qytetare dhe juridike, ashtu siç e kërkojnë  
22 rregullat. Prandaj kam qenë këtu, jam këtu.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
24 tej ju falënderoj për këtë reagim. Gjithashtu - jo, z. Shala.  
25 Po flas unë tani. Dhe nuk do ta jap fjalën tani.

1 Ule dorën, ju lutem. Se lodhet krahu. Do vijë një moment  
2 që ta jap fjalën. Po jo tani, që po flas.

3 Gjithashtu, znj. Dëshmitare, lidhur me dje, ju rikujtoj  
4 se duhet t'i përgjigjeni pyetjeve që ju bëhen, të mos e  
5 laboroni në çështje tjera, të mos shtjelloni çështje tjera. Ju  
6 këshilloj që të qëndroni e qetë, të mos e ngrini zërin kur  
7 përgjigjeni dhe të trajtoni me respekt personat që ju bëjnë  
8 pyetjet.

9 Ju lutem, silluni siç duhet në këtë sallë gjyqi. Nuk do  
10 të hezitoj të ndërhyj dhe t'ju ndërpres, në qoftë se ju nuk i  
11 ndiqni këto rregulla dhe të marrë masat e duhura, që është  
12 t'ju ndërpres fjalën dhe të ndërpres edhe përkthimin, që të  
13 mos dëgjohet jashtë sallës. Jam e sigurt që ju e kuptoni këtë.

14 Përpara se të vazhdojmë më tej me pyetjet e parashtruara  
15 nga Mbrojtësi i Viktimave, tani do pyes z. Shala se çfarë  
16 kishte për të thënë.

17 Z. Shala, fjalën e keni ju.

18 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit. Vetëm  
19 për sqarim, e nderuara Gjyqtare, nuk është se ekipi im e ka  
20 ftuar, po e ka involvuar Prokuroria me dëshmi të rreme. E ne  
21 jemi vetëm për sqarim. Vetëm për një sqarim, nuk është se e  
22 kemi involvuna ne dhe e kemi ftu ne.

23 Ne e kemi ftu për me sqaru deklaratat që i ka bë dikush  
24 tjetër dhe që ka involvuar, jo unë, as Mbrojtja jeme. Ju  
25 faleminderit. Kaq pata. Vetëm për sqarimin e sqarimit tuaj.

1 Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit për këtë ndërhyrje, z. Shala. Atëherë vazhdojmë.

4 Mbrojtësi i Viktimave, i drejtohem Mbrojtësit të  
5 Viktimave, palët i kanë përfunduar pyetjet e tyre radhën e  
6 keni ju për të parashtruar pyetjet tuaja.

7 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

8 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

9 Z. LAWS: [Përkthim]

10 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitare. Do të prezantohem tani. Quhem  
11 Simon Laws, jam avokat që përfaqësoj viktimat në këtë çështje.

12 Së pari, do t'ju pyes, do pyetjen në vijim. Dje u pyetët  
13 nëse jeni trajnuar ndonjëherë si motër medicinale. Kjo gjendet  
14 në transkriptin në faqen 78, rreshti 11. Unë dua t'ju bëj një  
15 pyetje pak më ndryshe. A keni mësuar ndihmën e parë mjekësore,  
16 si jepet ndihma e parë?

17 PË. Z. Avokat, kurrë në jetën time nuk kam mësuar se si jepet  
18 ndihma e parë dhe as sot nuk di sesi jepet ndihma e parë. E  
19 them me përgjegjësi dhe nën betim.

20 PY. Në karrierën tuaj si mësuese, a ju kanë mësuar ndonjëherë  
21 ju sesi jepet ndihma e parë?

22 PË. Jo, kurrë. Unë kam qenë mësuese e lëndëve ekonomike,  
23 s'kam pasë lidhje me asnjë gjë që ka pasë të bëjë me  
24 shëndetësi apo me mjekësi apo me asgjë.

25 PY. A do të ishit në gjendje të ndihmonit dikë që ka nevojë

1 që t'i vihen fasho në një plagë, për shembull, a do ishit në  
2 gjendje me bë këtë?

3 PË. Jo, nuk jam në gjendje me e bë. Edhe po ta prej pak  
4 gishtin tim, duhet me kërk ndihmë se kam frikë me ja nu një  
5 fashë vetit. S'kam lidhje me shëndetësien.

6 PY. Ju po na thoni që nuk dini sesi të vini një fasho në një  
7 plagë?

8 PË. Jo.

9 PY. Do keni nevojë për të kërk ndihmë edhe po të prisni pak  
10 gishtin?

11 PË. Jo, nuk kam dijeni. Kurrë askujt s'i kam dhënë ndihmën e  
12 parë dhe kurrë askush s'ka kërk nga unë me i dhënë ndihmën e  
13 parë, se e dinë që unë jam një ekonomiste dhe s'kam lidhje me  
14 shëndetësi.

15 PY. A keni pa ndonjë dikë ndonjë person duke vënë fasho në  
16 një plagë, çfarëdolloj plage ndonjëherë?

17 PË. Kur kam shku te mjeku që më ka ra gripi, ka pasë rast në  
18 shtëpi të shëndetit me e pa mjekun duke e bë një gjë të tillë,  
19 po unë kam pasë kurrë rast me i dhënë ndihmë kujna. As më ka  
20 kërk kush ndihmë. As nuk di me i dhënë kujt ndihmë.

21 PY. A ishte gjë e vështirë, t'u duk e vështirë kur pe  
22 doktorin sesi e vente fashon tek një person, për shembull, a  
23 dukej diçka e vështirë për t'u bë?

24 PË. Po as që ju kam afër afër mjekut. Unë shkoj për nevoja të  
25 mia, nuk kam shku për këtë çështje. Po flasim për periudhën e

1 pasluftës, tash kur shkoj te mjeku. S'kam lidhje me këtë punë.

2 PY. A dini nga cili fshat është Time Kadriaaj?

3 PË. Unë mesa di ajo jeton në Deçan, a në Prishtinë. Nuk e di.

4 Deputete është në parlamentin e Kosovë, s'e di ku ka

5 vendqëndrimin.

6 PY. Nuk ju pyeta për punën apo vendbanimin. Po fshatit prej

7 cilit vjen si origjinë, prej ka vjen. A e dini prej ka vjen

8 ajo, prej ka është si fshat?

9 PË. Me sa di unë, fshati i origjinës është Rastovicë.

10 PY. Kështu është në fakt. Sa larg Rastovica nga Vokshi?

11 PË. Z. Avokat, unë nuk jetoj në Voksh. Unë kam lind në Voksh,

12 po jetoj në Deçan.

13 PY. E di këtë. Se dje deklarove që ke lëvizë nga Vokshi në

14 Deçan kur ke qenë 10 apo 11 vjeç. Unë s'po ju pyes se ku

15 jetoni. Thjesht po ju pyes sa larg është Vokshi nga Rastovica?

16 PË. Po të them të drejtën, nuk mund ta them saktë kilometrat

17 se nuk i kam matë kurrë. Po nuk janë larg.

18 PY. Nuk po ju kërkoj distancën e saktë, por a është 5

19 kilometra, 100 kilometra larg a --

20 PË. Jo, nuk është --

21 PY. -- për aq sa mundeni ju me e përcaktu?

22 PË. 100 kilometra nuk është, po ndoshta 12, 13. Po nuk është

23 e saktë, mos e merrni shifër të saktë këtë, sesa kam mat

24 kurrë. S'ka qenë diçka e rëndësishme kjo për me e ditë. Unë e

25 di që Deçani është Prelepi, pas Prelepit është Rastovica, po



1 unë nuk e di kurrë sa kilometra i kanë.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk besoj që duhet ta pyesim, t'i  
3 kërkojmë dëshmitares që të hamendësojë. Ajo tha nuk e di. Në  
4 pikëpamjen time dha një -- u përgjigj në mënyrë të arsyeshme,  
5 nuk duhet t'i kërkojmë të hamendësojë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo  
7 nuk po hamendëson. Tani po flasim për një vlerësim të  
8 përafërt, ndryshe nga hamendësimi. Besoj që kjo pyetje mund të  
9 kishte marrë përgjigje para pesë minutash tashmë, me njërin  
10 prej gjërave që u tha. Mendoj që dëshmitarja po e detyron  
11 Mbrojtësin e Viktimave që të këmbëngulë më shumë sesa është e  
12 nevojshme. Po ia lë atij të vazhdojë më tej.

13 Z. LAWS: [Përkthim]

14 PY. Nga Rastovica në Deçan dhe kjo është distancë e shkurtër,  
15 apo jo? Disa minuta në makinë.

16 PË. Po, distancë e shkurtër është.

17 PY. A dini nëse Time Kadriaj do të vijë të japë dëshmi në  
18 këtë çështje?

19 PË. Jo.

20 PY. Nuk e dini?

21 PË. Jo.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Tani do kërkoj që të kalojmë në  
24 seancë private shkurtimisht. Në qoftë se më lejoni do t'i jap  
25 arsyet për këtë në mungesë të dëshmitares, pasi të largojmë

1 dëshmitaren nga salla.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Sekretare, na kaloni në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi tani në seancë  
3 publike.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Faleminderit.

6 Mbrojtësi i Viktimave, vazhdoni.

7 Z. LAWS: [Përkthim]

8 PY. Znj. Dëshmitare, dje -- dhe po ju referohem faqes 99 të  
9 transkriptit, rreshti 8. Dje, thatë që sipas jush, në  
10 pikëpamjen tuaj, akuzat e ngritura kundër disa pjesëtarëve të  
11 UÇK-së përfshi Kadri Veselin ishin të motivuara politikisht.  
12 Dhe pastaj më poshtë, në fund të faqes 99, fillim të faqes  
13 100, thatë:

14 "Të gjitha këto janë të sajuara, të fabrikuara nga  
15 policia serbe të cilët sjellin këtu dëshmitarë të sajuar dhe  
16 dëshmi të sajuara".

17 A ju kujtohet që keni thënë këtë dje?

18 PË. Po.

19 PY. Kur u prezantova para jush para disa çastesh, ju thashë  
20 që jam Mbrojtësi i Viktimave, dua t'ju pyes nëse e kuptoni  
21 rolin tim në këtë çështje?

22 PË. Po.

23 PY. Unë këtu përfaqësoj viktimat e krimeve që kanë ndodhur në  
24 Kukës, a e kuptoni këtë?

25 PË. Këtë që e thua e kuptoj, po unë nuk e kuptoj që në Kukës

1 ka pasë krime. Dhe jam e bindun që aty nuk ka pasë krime.  
2 PY. Këtë desha të pyes edhe unë. Sipas jush si është e mundur  
3 që të ketë viktima në qoftë se s'kanë ndodhë krime? A mund të  
4 na jepni pikëpamjen tuaj lidhur me këtë?

5 PË. Unë nuk kam dijeni që ka pasë viktima aty. Të paktën unë  
6 s'kam dijeni.

7 PY. A mendoni, znj. Dëshmitare, që kjo mund të jetë për shkak  
8 se, pjesërisht, për shkak se ju s'keni lexu materialet e kësaj  
9 çështjeje?

10 PË. Unë ju kam thënë edhe dje, po ju them edhe sot,  
11 materialet e kësaj çështjeje nuk i lexoj, sepse janë sajesa të  
12 shërbimit sekret serb dhe nuk dua as me i lexu. Z. Avokat, unë  
13 që jam ulur këtu si dëshmitar, jam viktimë e regjimit  
14 gjenicidial të Serbisë dhe kurrkush nuk po merret me të  
15 drejtat dhe jetën time këtu. Kërrkush nuk po më mbron mu që  
16 kam -- okej.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit, znj. Dëshmitare.

19 Vazhdo, z. Mbrojtësi i Viktimave.

20 Z. LAWS: [Përkthim]

21 PY. Në qoftë se nuk lexon asgjë që ka të bëjë me këtë  
22 çështje, si mund të arrish në përfundimin që sapo na the?

23 PË. Unë arrij në përfundimin që sapo thashë, sepse nuk kam  
24 dëgju kurrë nga askush që ka pasë gjëra të tilla në Kukës dhe  
25 unë kam të drejtë ta ruaj mendimin tim të bazuar në këtë, që

1 ajo çka po thoni ju ndalesën në Kukës a çka është, është  
2 sajësë e shërbimit sekret serb, prandaj nuk më interesojnë  
3 gjëra të tilla t'i lexoj. Unë nuk kam dëgju kurrë që ka pasë  
4 një gjë të atillë aty. Sikur ta kisha dëgju prej dikuj, unë do  
5 tua thojsha me sinqeritetin më të madh, po nuk kam dëgju. Nuk  
6 kam informatë që aty ka pasë diçka. Nuk i ndëgjoj, as nuk i  
7 lexoj thashethenet e kësaj Gjykate që ka rrëshqitë nga ajo për  
8 të cilën është formu.

9 PY. Në jetën tuaj profesionale si ekonomiste, fillimisht kur  
10 bëni një punë a nuk shikoni fillimisht provat dhe më pas  
11 nxirrnin përfundimet apo vendosni për përfundimin pa parë  
12 prova?

13 PË. Z. Avokat, po ka provë më të mirë dhe ma të fuqishme se  
14 vetë qëndresa jeme këtu që vij dhe dëshmoj për një person që  
15 s'e njoh, për një profesion s'e kam dhe për një vend që s'kam  
16 qenë kurrë.

17 Z. Prokuror, pyetja të cilën ma ka bë dje Avokatja, mu ka  
18 shqetësuar sepse është identike me pyetjen që ma ka bë Serbia  
19 në stacionin policor në Pejë. Okej.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
21 Dëshmitare, ju lutem thjesht përgjigjuni pyetjes. Kaq.

22 DËSHMITARJA: Në rregull.

23 Z. LAWS: [Përkthim]

24 PY. Doni t'ua përsëris edhe një herë pyetjen? A doni t'ua  
25 përsërisë edhe një herë pyetjen apo ju kujtohet pyetja që ju

1 bëra?

2 PË. Jo, s'më kujtohet. Përsërite.

3 PY. Në jetën tuaj profesioniste si ekonomiste, kur bëni një  
4 punë fillimisht a shihni evidencat, provat dhe më pas nxirrni  
5 përfundimin apo ju e vendosni paraprakisht përfundimin pa parë  
6 më parë provat?

7 PË. Unë jam ekonomiste dhe i përcjelli dhe jam e specializuar  
8 në fushën e buxhetit dhe kujtohet që i shikoj. Dhe në bazë të  
9 atyre nxjerri përfundimet sa i përket buxhetit. Këto sajesa të  
10 shërbimit sekret serb nuk du me i lexu kurrë, sepse më  
11 rikthejnë në një kohë të vështirë. Dhe ndihem jashtëzakonisht  
12 keq, siç jam ndi keq mbrëmë, sepse zyrat e rrahjeve të  
13 njerëzve në stacionin policor të Serbisë mbrëmë nuk më kanë  
14 lënë të flejë, z. Avokat.

15 Të cilët janë bë nga policia e një regjimi diktatorial,  
16 gjenocidial i Serbisë. A e kupton ti këtë gjë? Unë kam parë  
17 njerëz -- okej.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
19 Dëshmitare. E dëgjuam që nuk jeni ndjerë mirë dhe sepse ju  
20 sjell kujtime që nuk doni t'i sillni më ndërmend. Ne e  
21 vlerësojmë shumë faktin që keni ardhur, faktin që po jepni  
22 dëshmi. Por unë përsëris edhe njëherë, ju lutem vetëm jepini  
23 përgjigje pyetjes që ju kanë drejtuar. Nuk keni ardhur këtu  
24 për asnjë qëllim tjetër. Keni ardhur këtu vetëm për t'u  
25 përgjigjur pyetjeve që ju bëjnë.

1 Mbrojtësi i Viktimave, mund të vazhdoni për këtë temë.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Unë përfundova.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se po  
4 përsërisnit veten.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Mbarova me atë temë.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk besoj se duhet t'i kërkojmë  
7 dëshmitares të justifikojë mendimet e saj, qofshin këto të  
8 mira a të këqija. Këto janë mendime të dëshmitares. I kemi  
9 dëgjuar disa shpjegime. Jemi a s'jemi ët bindur është tjetër  
10 gjë. Po pse po vazhdojmë? Nuk është kjo në kuadër të pyetjeve  
11 tona edhe sikur dhe për të testuar besueshmërinë.

12 Ne e dimë tani qartë pozicionin e dëshmitares.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ia  
14 jap fjalën Mbrojtësit të Viktimave. Megjithatë, qëndrimet e  
15 një personi mund të vihen në dyshim sigurisht edhe prandaj  
16 përdoren dhe argumentet. Unë nuk shoh asnjë problem në pyetjet  
17 e Mbrojtësit të Viktimave.

18 Kështu që Mbrojtësi i Viktimave keni fjalën në qoftë se  
19 doni të kundërpërgjigjeni.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk pajtohem absolutisht me atë që  
21 tha Avokati Mbrojtës. Personat që unë përfaqësoj nuk kanë  
22 ardhur këtu, nuk është e drejtë që atyre t'u mohohet, pra, t'u  
23 mohohen krimet nga të cilat kanë vuajtur. Nuk është kjo  
24 drejtësi. Prandaj jam unë këtu, që t'i përfaqësoj ata përmes  
25 pyetjeve të mia. Ta eksplorojmë pozicionin e dëshmitares.



1 Kam dhe një pyetje tjetër dhe shpresoj që me kaq do të  
2 mbyll dhe temën time.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
4 vazhdoni.

5 Z. LAWS: [Përkthim]

6 PY. Znj. Dëshmitare, do t'ju bëj një pyetje. Ju lutem më  
7 dëgjoni dhe nëse mundeni përgjigjuni dhe ju lutem nëse  
8 përgjigjeni mos e ngrini zërin. Pyetja është kjo: A e keni  
9 menduar ndonjëherë se sa e dhimbshme mund të jetë për personat  
10 që kanë vuajtur në Kukës, të cilëve ju vuajtën të dashurit ose  
11 ju vranë njerëzit e dashur, e kuptoni sa e dhimbshme është për  
12 ata të dëgjojnë dikë që thotë është një gënjeshtër, janë të  
13 gjitha gënjeshtera dhe të gjitha sajesa politike? Pra, a u merr  
14 ndonjëherë mendja sa e dhimbshme mund të jetë për këta  
15 persona?

16 PË. A mund të përgjigjem?

17 PË. Patjetër. Po.

18 PY. Unë kam bindjen e plotë që në Kukës nuk ka pasë ndonjë  
19 rast të tillë që i ka shkakto këtë gjë që po thoni ju viktimat.  
20 Unë nuk du që në shtetin tim, në Kosovën time të lirë të ketë  
21 viktimat dhe dua të zbardhet gjithçka, mirëpo nuk pajtohna  
22 kurrë që dikush me u bë viktimë mbi gënjeshtërën. Apo nuk  
23 pajtohna kurrë që nga shërbimet sekrete serbe me u bë  
24 dëshmitar i rrejshëm, me këtë nuk pajtohna kurrë.

25 Kurse një popull i tërë në Kosovë jemi viktimë e një

1 gjenocidi serb që ka ndodhë aty dhe nuk dua të ketë asnjë  
2 viktimë nga --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
4 ishte kjo pyetje. Jua kam mbyllur mikrofonin nuk po bëhet më  
5 përkthimi i fjalës suaj. E dhatë përgjigjen. Unë e shtypa  
6 mikrofonin, e bllokova pjesën tjetër të përgjigjes e cila tani  
7 nuk është pasqyruar.

8 Unë ju kërkova thjeshtë t'u përgjigjeni pyetjeve dhe jo  
9 të merrni fjalën dhe të thoni çfarë dëshironi ju. Nuk është ky  
10 vendi dhe nuk është vend ky që të zgjedhësh dhe të mos  
11 përgjigjes, se me sa duket për ju qenka shumë e vështirë kjo  
12 gjë.

13 Mbrojtës i Viktimave, vazhdoni.

14 Z. LAWS: [Përkthim]

15 PY. Po një pyetje e thjeshtë ishte kjo mund t'i përgjigjeni  
16 me "po" ose me "jo". Pra, a u ka shkuar ndonjëherë nëpër mend  
17 se sa e dhimbshme mund të jetë për personat t'ju dëgjojnë ju  
18 tani që po thoni që janë të gjitha gënjeshtër dhe se nuk ka  
19 viktima? A u ka shkuar ndonjëherë nëpër mend kjo gjë, "po" apo  
20 "jo"?

21 PË. Unë nuk di që ka pasë aty viktima.

22 PY. Po ju jap një shans të fundit të përgjigjeni dhe më pas  
23 do ulem. A ju ka shkuar ndonjëherë nëpër mend sesa e dhimbshme  
24 mund të jetë që ju thoni këto gjëra dhe personat t'ju dëgjojnë  
25 teksa thoni këto gjëra, viktimat e vërteta? Unë nuk po ju pyes

1 a ka apo s'ka viktimat të vërteta. Por po them a e keni menduar  
2 ju vetë ndonjëherë, po apo jo?

3 PË. As që e kam mendu sepse jam e bindur që ajo qëndër është  
4 sajësë e shërbimit sekret serb. Unë jam këtu e ulur mbi një  
5 dëshmi të rreme. Kaq di.

6 PY. E kuptoj. Faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, Mbrojtës i Viktimave.

9 Dhe faleminderit, znj. Dëshmitare.

10 Po shoh Mbrojtjen. Z. Gilissen, keni nevojë për një raund  
11 tjetër pyetjesh? Dje thatë se jo, por po sigurohem se mund të  
12 këtë pasur ndonjë ndryshim.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Jo, nuk kemi pyetje  
14 të mëtejshme.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
16 rregull.

17 Atëherë seanca përfundon këtu. Faleminderit. Po shoh  
18 njëherë kolegët sidoqoftë.

19 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

21 Dëshmitare, nuk ka pyetje nga Gjyqtarët e Panelit, që do të  
22 thotë se përfundam me dëshminë tuaj sot. Faleminderit për

23 përpjekjet tuaja, për dëshminë tuaj përpara këtij Trupi

24 Gjykes, shumë faleminderit për këtë.

25 DËSHMITARJA: Faleminderit edhe prej juve. Jam pak e

1 shqetësuar që nuk ma ke dhënë mundësinë me fol, por i kuptoj  
2 rregullat e gjyqit. Unë jam institucionaliste, besoj në  
3 drejtësi. Dhe ju, Panel i Gjyqtarëve, kam bindjen që nuk do të  
4 dëgjoni as këtë palë, as këtë palë, por do ta analizoni  
5 situatën dhe do ta nxirrni të vërtetën dhe vetëm të vërtetën  
6 dhe do ta thoni drejtësinë këtu.

7 Nëse ka drejtësi në këtë Gjykatë, ai burrë që është sot  
8 nuk ia pava fytyrën do të lirohet do të shkoj --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
10 Dëshmitare, mjafton. Mjafton. Ne thjesht deshëm t'ju thonim  
11 rrugë të mbarë.

12 DËSHMITARJA: Faleminderit. Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
14 duhet t'ju kujtoj se nuk duhet të diskutoni dëshminë që keni  
15 dhënë përpara Dhomave të specializuara me askënd. Dhe tani  
16 Asistentja e sallës së gjyqit do ju shoqërojë jashtë.

17 DËSHMITARJA: A mund ta them edhe një gjë? Për ato çka  
18 janë publike --

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
20 jo, jo. Nuk ju lejohet më të thoni asnjë. Përfundoi këtu.  
21 Faleminderit.

22 [Dëshmitarja largohet]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
24 atëherë. Ora është 10.00 e një çerek. Do bëjmë çerek ore  
25 pushim dhe do rifillojmë me dëshmitaren e radhës, në qoftë se

1 dhe ju jeni dakord.

2 Shoh që po pohoni me kokë.

3 Mirë atëherë. Pastaj kalendari do jetë si zakonisht deri  
4 në 11.00, gjysëm ore pushim dhe si zakonisht pastaj gjatë  
5 ditës.

6 Seanca ndërpritet këtu.

7 --- Pauza fillon në orën 10.13

8 --- Seanca rifillon në orën 13.32

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
10 se u kthyet. A ka ndryshime në ekipin e ZPS-së?

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Mbrojtësi i Viktimave? Jo.

14 Avokati Mbrojtës?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi i njëjti ekip.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
17 rregull. Do të vazhdojmë -- do të fillojmë me dëshminë e  
18 dëshmitares 04440, znj. Time Kadriaj. Do japë dëshmi pa masa  
19 mbrojtëse në sallën e gjyqit. Para se të vijë dëshmitarja, dua  
20 të kalojmë për një çast në seancë private.

21 Sekretare e Gjykatës të kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Asistente, ju lutem sillni dëshmitaren në sallë.

24 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Mirëdita, mirë se erdhët para Dhomave të Specializuara. A më  
2 dëgjoni?

3 DËSHMITARJA: Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
5 Shala, mirëdita. E dëgjoni dëshmitaren?

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita, dëgjoj fort  
7 mirë, faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit, z. Shala.

10 Znj. Dëshmitare, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj.  
11 Akoma nuk e kam të qartë pse duhet t'ju dërgonim ftesë për të  
12 qenë e pranishme në sallën e gjyqit, por sidoqoftë iku tani,  
13 dhe jemi këtu. Unë dua t'ju shpjegoj arsyen pse jeni thirrur  
14 për dhënë dëshmi përpara Trupit Gjykses.

15 Është me kërkesë të ekipit të Mbrojtjes të z. Shala, të  
16 akuzuarit në këtë çështje gjyqësore, që t'ju thërrisim të  
17 jepnit dëshmi, sepse vetë Mbrojtja nuk arriti t'ju merrte si  
18 dëshmitare. Dhe Mbrojtja gjykoi se dëshmia juaj është e  
19 rëndësishme për çështjen e z. Shala. Trupi Gjykses e miratoi  
20 kërkesën e Mbrojtjes sepse ka të ngjarë që ju të keni  
21 informata për ndonjë krim dhe/ose kryesit e mundshëm dhe/ose  
22 rrethana të rëndësishme, të rëndësishme për këtë proces penal,  
23 në çështjen gjyqësore kundër Pjetër Shalës. Edhe mundësinë a i  
24 keni apo s'i keni ju këtë informata i vlerëson Trupi Gjykses.  
25 Ju, si dëshmitare, keni përgjegjësinë të vini, të përgjigjeni



1 dhe na bëhet qejfi që tashmë jeni këtu dhe uroj që këtë ta  
2 keni të qartë.

3 DËSHMITARJA: Faleminderit. Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Përpara se të fillojmë me pyetjet që i kemi për ju, do t'ju  
6 jap disa, do bëj disa këshilla, sikurse bëjmë me të gjithë  
7 dëshmitarët.

8 Znj. Dëshmitare, jeni thirrur për të dhënë dëshmi përpara  
9 Dhomave të Specializuara në çështjen Prokurori i Specializuar  
10 kundër Pjetër Shalës, për të ndihmuar Trupin Gjykes që të  
11 dalë me vendim.

12 Së pari, do të bëni deklaratën solemne se do të thoni të  
13 vërtetën. Më pas do t'ju bëjë pyetje fillimisht ekipi i  
14 Mbrojtjes së z. Shala. Më pas përfaqësuesit e Zyrës së  
15 Prokurorit të Specializuar që janë me mantelin me ngjyrë  
16 vjollcë, dhe më pas Avokati që përfaqëson viktimat në këtë  
17 çështje gjyqësore që po shihni ju në drejtimin e duhur, dhe më  
18 pas ne, Gjykatësit e Trupit Gjykes.

19 Përpara se të bëni deklaratën solemne, dëshiroj t'ju jap  
20 disa këshilla të mëtutjeshme që mund t'ju ndihmojnë me  
21 dëshminë tuaj.

22 Znj. Dëshmitare, dëgjoni me vëmendje pyetjet. Nëse nuk e  
23 kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet.

24 Ne duam të thoni të vërtetën, çfarë keni parë, çfarë keni  
25 dëgjuar, çfarë keni përjetuar ju personalisht. Në qoftë se

1 diçka nuk e keni dëgjuar dhe nuk e keni parë vetë, na thoni  
2 nga e keni mësuar.

3 Mbase nuk do ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve,  
4 dhe kjo është krejt normale, ju lutem jepni dëshmi vetëm për  
5 ato gjëra që ju kujtohen. Mos supozoni, mos trilloni, nuk ka  
6 asgjë të gabuar të thuash "Nuk e di". Në rregull?

7 Ju lutem, përgjigjuni vetëm pyetjes që ju drejtojnë. Nëse  
8 ka për më shumë sqarime, do të bëhen pyetje vijuese.

9 Gjithashtu, ju kujtoj se keni të drejtën të mos jepni  
10 dëshmi për elementë që mund t'ju vetë-inkriminojnë në bazë të  
11 rregullës 151(1) i Rregullores së procedurës dhe provave.

12 A i kuptuat këto?

13 DËSHMITARJA: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani,  
15 sa i takon disa këshillave të tjera praktike, më dëgjoni me  
16 vëmendje.

17 Çdo gjë që thuhet këtu përkthehet edhe ruhet në një  
18 procesverbal. Është e rëndësishme që të flisni në mikrofonat  
19 që keni përballë, të flisni ngadalë dhe të flisni qartë, sepse  
20 kjo i jep mundësi përkthyesve dhe stenografit që të përkthejnë  
21 edhe të zbardhin çdo gjë. Ju lutem flisni vetëm pasi personi  
22 që ju ka bërë pyetjen e ka përfunduar këtë pyetje, prandaj  
23 është e dobishme të numëroni deri në pesë me mendje, dhe  
24 pastaj përgjigjuni. E shoh që po buzëqeshni, por është shumë i  
25 rëndësishëm pesë sekondëshi përndryshe kemi folës që flasin

1 njëherazi dhe mbase po të keni parë seanca të tjera të kësaj  
2 Gjykate, do ta kuptoni që në qoftë se folësit flasin  
3 njëherazi, as përkthimi nuk bëhet, as nuk zbardhet fjalimi  
4 juaj, dëshmia juaj.

5 Nëse ngre dorën, ju lutem ndaloni së foluri. Unë e ngre  
6 dorën që të mos flasim njëherazi. Por ndonjëherë në qoftë se  
7 nuk e ngre dorën, do të detyrohem që të flas me zë dhe kjo  
8 krijon një farë pengese për përkthimin. As ti as unë s'mund të  
9 përktheheni më pastaj.

10 Mund t'ju kërkojmë të bëni shënime në ndonjë dokument.  
11 Për këtë qëllim keni një laps pranë kompjuterit. Do t'ju  
12 ndihmojë Asistentja e Gjykatës për këtë. Megjithëse nuk jemi  
13 të sigurt a do jetë e nevojshme në rastin tuaj.

14 Së fundi, nëse keni pyetje, nëse ju nevojitet pushim, apo  
15 asistencë për diçka, ju lutem ngrini dorën dhe do t'ju jap  
16 fjalën.

17 A i kuptuat të gjitha këto?

18 DËSHMITARJA: Po. Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Siç  
20 bëjmë me të gjithë dëshmitarët, tani do ju kërkojmë që të  
21 lexoni deklaratën solemne se do të thoni të vërtetën. Znj.  
22 Dëshmitare, ju kujtoj se është vepër penale në juridiksionin e  
23 Dhomave të Specializuara që të jepni dëshmi të rreme. E  
24 kuptoni këtë?

25 DËSHMITARJA: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
2 mirë.

3 Asistente e Gjykatës, ndihmojeni dëshmitaren me tekstin.

4 Lexoni tekstin që keni përballë.

5 DËSHMITARJA: I ndërgjegjshëm / e ndërgjegjshme për  
6 rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore,  
7 deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të  
8 vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë  
9 asgjë për të cilën kam dijeni.

10 DËSHMITARJA: W04440

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
12 faleminderit, znj. Dëshmitare. Tani jeni nën betim për të  
13 thënë të vërtetën.

14 Sekretare e Gjykatës, të kalojmë sërish në seancë  
15 private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Znj. Dëshmitare, tani mund të fillojmë me dëshminë tuaj.

11 Dhe do të fillomë me pyetjet nga ekipi i Mbrojtjes.

12 Avokat, keni një orë e gjysmë për pyetjet tuaja për këtë

13 dëshmitare. Ju lutem, informoni Trupin Gjygues nëse ka

14 ndryshim sepse na duhet të bëjmë organizimet e nevojshme.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Patjetër që do jua njoftojmë.

16 Pyetje nga z. Gilissen:

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]

18 PY. Mirëdita, znj. Dëshmitare. Sikurse ju e dini, unë jam

19 Avokati Mbrojtës i z. Shala. Dhe unë dua të trajtojmë bashkë

20 disa aspekte dhe t'ju bëj disa pyetje në mënyrë që të marrim

21 sa më shumë informacion prej jush. Sikurse ju tha dhe

22 Kryegjykatësja, mos supozoni, na thoni vetëm informacione të

23 qarta dhe të sigurta. Faleminderit.

24 Dhe znj. Dëshmitare, a mund të na thoni emrin dhe

25 mbiemrin?

- 1 PË. Time Kadriaaj.
- 2 PY. Faleminderit. A mund të na thoni datëlindjen dhe  
3 vendlindjen tuaj?
- 4 PË. 14.02.1965, Rastavicë, në Deçan.
- 5 PY. Faleminderit. A keni ndonjë nofkë, apo keni pasur ndonjë  
6 nofkë në të shkuarën?
- 7 PË. Jo.
- 8 PY. Çfarë niveli arsimit keni?
- 9 PË. Superior.
- 10 PY. A mund të na shpjegoni më shumë çfarë do të thotë? Çfarë  
11 diplome?
- 12 PË. E kam kry fakultetin e mjekësisë si mjekë e përgjithshme,  
13 e kam kry specializimin si gjinekologe.
- 14 PY. Aktualisht çfarë profesioni keni?
- 15 PË. Jam deputete e Republikës së Kosovës.
- 16 PY. A mund t'ju pyes me cilën parti jeni? Cilës parti i  
17 përkisni?
- 18 PË. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.
- 19 PY. AAK-ja. A mund të na shpjegoni kush e ka themeluar këtë  
20 parti?
- 21 PË. Ramush Haradinaj.
- 22 PY. Shumë faleminderit. Shumë e qartë. Znj. Dëshmitare, ku  
23 keni jetuar përpara fillimit të luftës në vitin 1998?
- 24 PË. Në fshatin tim të lindjes, Rastavicë.
- 25 PY. A punonit asokohe?



1 PË. E kam përfunduar fakultetin në vitin 1996. Dhe në atë kohë  
2 për shkak të mbylljes së institucioneve shëndetësore dhe  
3 arsimore, kam punuar si mjekë e re në shoqatën humanitare  
4 "Nënë Tereza".

5 PY. Faleminderit. Në vitin 1999, a u kyçët në UÇK?

6 PË. Po.

7 PY. Kur jeni kyçët në UÇK?

8 PË. Në UÇK jam kyçët në vitin 1998.

9 PY. 1998, okej. A ju kujtohet muaji, muaji kur jeni kyçët?

10 PË. Mars, prill. Prill, ndoshta. S'jam shumë e sigurt.

11 PY. Faleminderit. A mund t'ju pyes pse u kyçët në UÇK?

12 PË. Po për shkak të regjimit të atëhershëm, represioneve, për  
13 shkak të gjithë atyre [E pakuptueshme] dhe pas ngjarjes që  
14 ndodhi në familjen Jashari, një numër i madh i qytetarëve janë  
15 mobilizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

16 PY. Shumë e qartë. Ju falënderoj. Znj. Dëshmitare, çfarë pune  
17 bënit ju me UÇK-në, çfarë pune bënit me UÇK-në në fshatin tuaj  
18 në komunën e Deçanit në 1998?

19 PË. Mjeko.

20 PY. Faleminderit. A mund të na shpjegoni konkretisht si ka  
21 qenë situata sa u takon personave që duhet t'u ofronit kujdes  
22 mjekësor? Si funksiononte organizimi në ato kohë?

23 PË. Për shkak të përhapjes së luftës në të gjitha anët,  
24 furnizimi me barna ka qenë i vështirë. Unë kam qëndruar në  
25 fshatin tim të lindjes për shkak se kemi qenë vijë e parë e

1 luftës, dhe aty kam shërbyer. Aty, gjithsecili ka kontribuar,  
2 secili fshatar ka kontribuar me aq sa ka pasë mundësi dhe me  
3 ato barna që i ka pasë në mënyrë -- dhe i kemi grumbullu në  
4 një shtëpi.

5 PY. Faleminderit. Në këto momente, a morët ndonjë trajnim,  
6 apo ndonjë ndihmë nga UÇK-ja për punën tuaj si mjeke?

7 PË. Jo. Meqenëse unë isha mjeke, kam punu në shoqatën "Nënë  
8 Tereza" për disa kohë, me automatizëm kam fillu me punu në  
9 fshatin e lindjes si mjeke.

10 PY. Faleminderit, shumë e qartë. Tani do të doja të dija, a  
11 jeni larguar ndonjëherë nga Kosova në vitin 1998 dhe 1999?

12 PË. Në, dikund në shtator, tetor 1998, jam larguar nga  
13 Kosova.

14 PY. A jeni në gjendje të na shpjegoni çfarë udhëtimi keni  
15 bërë, ku keni shkuar në atë kohë?

16 PË. Për shkak të ofensivave, jemi detyruar të largohemi. Dhe  
17 rruga të cilën e kemi ndjekë ka qenë Rugova, që është bjeshkë.  
18 Pastaj kemi dalë në Mal të Zi, në Ulqin, dhe me pas në Durrës  
19 për shkak se e kam pasë një pjesë të familjes atje.

20 PY. Në rregull. A qëndruat në Durrës deri në fund të luftës?

21 PË. Jo.

22 PY. Ku shkuat pas Durrësit?

23 PË. Mobilizimin e kam ba në Koshare. Domethënë, Papaj, Padesh  
24 dhe në Koshare.

25 PY. Kur keni mbërritë në Koshare?

- 1 PË. Fillimin e -- fillimi, ka qenë fillimet ndoshta të 1999.
- 2 PY. A ju kishin caktu ndonji detyrë me pozitë në Koshare apo
- 3 çfarë keni bo, me çfarë jeni marrë?
- 4 PË. Mjeke kam qenë.
- 5 PY. A keni marrë pjesë ndonjëherë në luftime si pjesëtare e
- 6 UÇK-së?
- 7 PË. Në Koshare kanë qenë edhe ekipa mjekësore, kanë qenë në
- 8 vijat e para të frontit. Për shkak të terrenit s'ka pasë
- 9 spital, dhe ekipi mjekësor është mobilizuar dhe ku ka pasë
- 10 nevojë ose ku ka pasë ndonjë të plagosur kemi shku me ndihmu.
- 11 PY. Çfarë lloji trajtimi mjekësor keni dhanë ju në Koshare?
- 12 PË. Ndhmën e parë mjekësore, domethënë ndaljen e
- 13 gjakderdhjes, ndihma e parë mjekësore, dhe më pas të
- 14 plagosurit i kemi transportuar në qytetin e Bajram Currit.
- 15 PY. Ku keni ndejtë në Koshare?
- 16 PË. Fillimi ka qenë në Papaj, që është pak ma larg. Para se
- 17 me fillu lufta frontale në, më 9 prill. Kemi ndejtë në Papaj
- 18 dhe me fillimin e luftës frontale jemi afruar në Padesh, që
- 19 është në kufi.
- 20 PY. Faleminderit. Si ishte organizuar stafi mjekësor i UÇK-së
- 21 në Shqipëri në 1999? A ishit njësi e veçantë?
- 22 PË. Unë muj me folë veç për këtë pjesën, jemi kanë një grup
- 23 të mjekëve, dhe kemi funksionu si ekip mjekësor. Nuk e di a ka
- 24 pasë nanji njësi apo emër, por kemi qenë si njësi e mjekëve.
- 25 PY. A keni pasë epror, a drejtor, a diçka të tillë?

1 PË. Me thanë të djejtën, kemi funksionu si ekip dhe s'e kemi  
2 pasë ndonji përgjegjës.

3 PY. Si ishte gjendja e popullsisë civile të Kosovës në  
4 Shqipëri në 1999?

5 PË. Po, unë nuk e di. E di për -- unë kam qëndruar atje prej  
6 fillimit deri në përfundim të luftës. Dhe aty në fakt ka pasë  
7 pak popullatë civile ose kanë qëndruar në Bajram Curr, ndërsa  
8 ka pasë popullsi të Shqipërisë që kanë qëndruar nëpër shtëpitë  
9 e veta në Paja dhe Padesh.

10 PY. Sipas jush, në Koshare, kjo puna a ka qenë e organizume,  
11 shumë e organizume, apo sipas analizës tuje, si --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Avokati Mbrojtës, ndoshta duhet të qartësoni se ku doni me  
14 dalë për të gjithë këtë. Për mu është të paktën e paqartë se  
15 ku do të dilni me këto pyetje?

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kuptojmë që është puna e saj që  
17 kjo ka qenë puna e saj. Unë dua të kuptoj mjedisin, ambientin,  
18 organizimin, si ka qenë e organizume. E kuptoj që kanë punuar  
19 në ekip, por -- pyetja e radhës do të ishte sa vetë, sa  
20 persona keni trajtuar?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Atëherë bëni pyetje më konkrete. Dhe pastaj bazuar në pyetje  
23 më konkrete mund të shtrihemi pastaj në çështje më, të  
24 trajtojmë çështjet më gjerësisht.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në rregull.

1 PY. Kërkoj ndjesë, znj. Dëshmitare. Sipas jush, në qoftë se  
2 ju kujtohet natyrisht, sa pacientë keni trajtu në këtë  
3 periudhë kohore në një ditë, përafërsisht?

4 PË. Kjo është mvarë prej dinamikës së luftimeve. S'mundet me  
5 u përcaktu sa pacientë ka pasë në ditë, sepse ndonjë ditë ka  
6 pasë ma shumë për shkak të dinamikës së luftimeve, ndonjë ditë  
7 ma pak. Por që në fakt s'muj me mbajtë mend sa ka qenë.

8 PY. Faleminderit. A keni shku në vende të tjera, jashtë  
9 Koshares për me trajtu ndonji person të lëndumë?

10 PË. Jo, sepse unë jam mobilizu në Koshare, kam qëndru në  
11 Koshare dhe prej Koshares jam kthy në Kosovë pas çlirimit.

12 PY. Faleminderit. A ke shku tek, në ndonjë bazë tjetër të  
13 UÇK-së në Shqipëri për arsye të punës tënde?

14 PË. S'kam pasë ndonjë punë tjetër. Unë, puna ime ka qenë me  
15 shërby dhe me e kry misionin tem të mjekut si humaniste dhe me  
16 qenë në shërbim të ushtarëve të plagosur, por edhe popullatës  
17 aty që ka qenë. Kështu që nuk kemi lëvizë prej Koshares.

18 PY. Kërkoj ndjesë që po këmbëngul. A ke shku ndonjëherë në  
19 Kukës në lidhje me punën tënde, pra në 1999?

20 PË. Unë s'kam pasë ndonjë punë tjetër, puna ime është me  
21 shërby ushtarëve dhe unë jam përcaktu me qenë në Koshare. Aty  
22 kam fillu dhe aty kam përfunduar.

23 Z. GILISSEN: [Nuk ka përkthim]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk  
25 është e qartë për mu.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të jem më konkret.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sepse  
3 nuk morëm përgjigje të qartë me po ose jo.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të shkoj në thelb të çështjes  
5 tani.

6 PY. A keni shku në Kukës për ndonjë arsye tjetër që nuk ka  
7 lidhje me punën tuaj në 1999? A keni qenë në Kukës qoftë edhe  
8 një herë në 1999?

9 PË. Jo.

10 PY. A e njihni apo e keni njohur një person me emrin Milaim  
11 Zeka?

12 PË. Milaimin e njoh se ka qenë në Koshare.

13 PY. A ka qenë ai në Koshare në maj të 1999?

14 PË. Nuk muj me e mbajtë mend saktë me datë me -- por ka qenë,  
15 ka qenë në Koshare. Me datë, me ditë, nuk e mbaj mend.

16 PY. Faleminderit. E kuptoj që ka kaluar shumë kohë, më shumë  
17 se 20 vjet. A ju kujtohet një person me emrin Nasim Haradinaj?

18 PË. Po.

19 PY. A e ke taku ndonjiherë atë në maj të 1999 në Shqipëri?

20 PË. Nasimi ka qenë në Koshare, unë e kam takuar Nasimin në  
21 Koshare.

22 PY. Qartë. Faleminderit. Ne kemi dëgju dëshmi që pretendon që  
23 ju keni qenë në qendër të UÇK-së në Kukës në uzinën mekanike  
24 në Kukës në maj të 1999. Dhe sipas kësaj dëshmie, ju bashkë me  
25 Milaimin keni shku në Kukës, me Milaim Zekën, i cili ka qenë i

1 lëndumë, për t'i dhënë ndihmë mjekësore atij, dhe Nasim  
2 Haradinaj gjithashtu. Pas kësaj Milaim Zeka ka marrë trajtim  
